

Njoftim: Mundësi punësimi në pozicionin Shërbim ndaj klientit në dyqanin EasyPay

Pozicioni: Shop Representative

Orari: Kohë e Plotë

Arsimi: I lartë

Eksperienca: Minimumi 1 vit punë në kompani të ngjashme.

Cilat janë detyrat kryesore që do të zhvilloni ?

- Kryeni pagesat nga sistemet e EasyPay për të gjitha shërbimet e ofruara sipas kërkesave të klientëve, duke ndjekur me përpikmëri të gjitha hapat e përcaktuara në procedurën e brendshme
- Tu përgjigjeni klientëve për problemet e ndryshme që ata reklamojnë, orientoni zgjidhjen e tyre në departamentet përkatëse;
- Kryeni këmbim valutash sipas kërkesave të klientëve
- Kryeni procesin e shërbimit të transfertave duke shërbyer klientët që paraqiten në Dyqan.
- Përgjegjës për shitjet në Dyqan të gjitha pajisjeve fizike
- Përgjegjës për mbajtjen e arkës duke kryer rakordimet ditore me kolegun e turnit pasues

Cilat janë kualifikimet që duhet të keni ?

- Arsim I Lartë / Bachelor;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Njohuri dhe eksperiencë mbi sistemin e pagesave elektronike, apo në kompani me profil të ngjashëm;
- Njohuri të mira mbi paketën Office 2010;
- Aftësi shumë të mira komunikimi, të tregoni se mendoni dhe mësoni shpejt duke treguar qetësi dhe maturi;
- Fleksibilitet për të kapërcyer sfidat e përditshme dhe të jeni të mirë organizuar në detaje;
- Aftësi të mira në menaxhimin e kohës në mënyrë efektive;
- Përkushtimin e duhur në punë, përgjegjshmërinë, iniciativa për të kryer sakte detyrat individuale si dhe të jeni i gatshëm të punoni në grup.

Dokumentacioni paraprak: CV, Kopje të Certifikatave, Diplomave të kualifikimeve të ndryshme duhet të dërgohen me email në adresën: hr@easypay.al.

****Do të lajmërohen për intervistë vetëm kandidatët që do të përzgjidhen të cilëve do t'u kërkohet dokumentacion shtesë.***

